

Për: Adem Ahmetaj, zv.Drejtor NJPMNP/Ministria e Ekonomisë
Qendresa Morina, analiste NJPMNP/Ministria e Ekonomisë
Leonora Sylja, UD Drejtore e Burimeve Njerëzore, Telekomi i Kosovës
Anëtarët e BtD TK-SHA

Kopje: Burbuqe Hana, UD Kryeshefe Ekzekutive/Telekomi i Kosovës SH.A
Shekip Fazliu, Këshilltar i përgjithshëm/Sekretar i Korporatës

Prej: Shpetim Dobra, Kryesues i BtD-TK SH.A.

Lënda: Ekstrakt nga Mbledhja e BtD nr.32 dt.18.10.2022_ Plotësim/Ndryshim i Rregullores për parandalimin e Konfliktit të Interesit në TK sh.a. me nr. prot.01-4433/21 të dt.31.12.2021

Datë: 18.10.2022

Të nderuar,

Për info dhe nevoja të Juaja procedurale e gjeni ekstraktin nga Mbledhja e e BtD nr.32 më dt. 18.10.2022 nën pikën e rendit të ditës nr.4. Propozim për Plotësim/ndryshim të Rregullores për parandalimin e Konfliktit të Interesit në TK sh.a. me nr. prot.01-4433/21 të dt.31.12.2021

Bazuar në propozimet dhe konstatimet e ofruara nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve, duke iu referuar dhe vepruar konform Ligjit për parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik nr.06/L-011, Bordi i Drejtorëve TK sh.a., merr këtë:

V E N D I M

për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr.prot.01-4433/21 dt.31.12.2021

1. Pika 1.3 e Nenit 10. Punët e ndaluara për zyrtarin e TK-së e cila përcakton: "Angazhimet e tilla mund të dëmtojnë imazhin dhe reputacionin e TK-së, të vlerësuar nga menaxhmenti", pjesa e fjalisë "të vlerësuar nga menaxhmenti" zëvendësohet me fjalinë "konform ligjit".
2. Pika 1.4 e Nenit 10. Punët e ndaluara për zyrtarin e TK-së e cila përcakton: "Angazhimi ka të bëjë me zgjedhjen, emërimin apo caktimin në subjektet kontraktuale të TK-së" ndryshohet me fjalinë "Nëse angazhimi i zyrtarit të TK-së ka të bëjë me zgjedhjen, emërimin apo caktimin në subjekte kontraktuale të TK-së, atëherë zyrtari duhet ti shmangët konfliktit të interesit duke marr masa për vetë përjashtim ose përjashtim paraprak nga procesi i vendimmarrjes, diskutimit dhe votimit të çështjes".
3. Pikat tjera të Rregullores për parandalimin e konfliktit të interesit mbesin të pandryshuara.
4. Obligohen Burimet Njerëzore dhe Menaxhmenti i TK sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi.

I dërgohet:
BORDIT TË DREJTORËVE
UD KE
NJPMNP
DEP. BNJ
SKE
ARKIVA

Vërejtje:

1. Interpretimi i vendimit të bashkangjitur mundet të kryhet vetëm duke u mbështetur në Procesverbalin e Mbl.nr.32, dt.18.10.2022 dhe korrespondencave të tjera nëse ka..